



Pasqyrat Financiare

SOLVENT RATING Sh.p.k

31 Dhjetor 2019

Përmbajtja


	Faqe
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	7
DEKLARATA E HARTUESIT TË PASQYRAVE FINANCIARE	17

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2019
(në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

AKTIVET	Shënime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Mjetet monetare dhe ekuivalente	4	1,995,815	1,632,905
Të tjera të drejta të arkëtueshme	5	71,407	38,843
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,067,222	1,671,749
Aktive afatgjata materiale, neto	6	52,792	38,481
Totali i aktiveve afatgjata		52,792	38,481
TOTALI I AKTIVEVE		2,120,014	1,710,229
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Furnitor	7	150,118	478,113
Paga te pagueshme	9	164,579	395,858
Te tjera te pagueshme	8	38,879	36,568
Detyrime ndaj shtetit	10	288,622	41,145
Huamarrje afatshkurtra	11	186,491	34,766
Totali i detyrimeve afatshkurtra		828,688	986,450
Huamarrje afatgjate	11	3,687,866	3,085,500
Totali i detyrimeve afatgjate		3,687,866	3,085,500
Totali i detyrimeve		4,516,555	4,071,950
Kapitali i regjistruar	12	100	100
Humbja e akumuluar		-2,396,640	-2,361,820
Totali i kapitalit		-2,396,540	-2,361,720
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		2,120,014	1,710,229

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë 20 më Maj 2020 dhe firmosur në emër të saj nga:


Predrag Janjic

Administrator



Shih shenimet shpjeguese qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2019
(në Lek)

Pasqyra e Performancës

	Shënime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të Ardhura			
Shitje shërbime	13	<u>9,242,860</u>	<u>206,747</u>
Të ardhurat totale		<u>9,242,860</u>	<u>206,747</u>
Kostot operative			
Shpenzime për personelin	14	-6,544,449	-1,402,016
Zhvlerësim dhe amortizim	6	-10,780	-1,584
Shpenzime administrative dhe të tjera	15	<u>-2,455,301</u>	<u>-1,078,172</u>
Totali i shpenzimeve operative		<u>-9,010,531</u>	<u>-2,481,772</u>
Fitimi/(humbja) neto nga operacionet		<u>232,329</u>	<u>-2,275,025</u>
Totali i të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	16	<u>-267,149</u>	<u>-86,795</u>
Fitimi (humbja) para tatimit		<u>-34,820</u>	<u>-2,361,820</u>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitim (humbja) për vitin		<u>-34,820</u>	<u>-2,361,820</u>

Shih shenimet shpjeguese që janë pjesë perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2019
(në Lek)

Pasqyra e Flukseve Monetare

	Shënime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytezimit			
Fitimi (humbja) para tatim fitimit		-34,820	-2,361,820
Rregullime për:			
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	6	10,780	1,584
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytezimit para rregullimeve në kapitalin punues		-24,040	-2,360,236
(Rritje) / ulje e llogarive të arkëtueshme dhe të tjera		-32,564	-38,843
Rritje / (ulje) në furnitorë dhe të tjera detyrime		-309,486	951,683
Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit		-366,090	-1,447,396
Tatim i paguar		-	-
Fluksi monetar neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		-366,090	-1,447,396
Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit			
Blerje aktiveve afat-gjata materiale	6	-25,092	-40,065
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë e investimit		-25,092	-40,065
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare			
Rritja e kapitalit		-	100
Financime huamarrje Afatgjate		602,366	3,085,500
Financime huamarrje Afatshkurter		151,725	34,766
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga/ (përdorur në) veprimtaritë financiare		754,091	3,120,366
Rritja/(ulja) neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente		362,909	1,632,905
Mjete monetare dhe ekuivalente më 1 Janar		1,632,905	-
Mjete monetare dhe ekuivalente më 31 Dhjetor		1,995,815	1,632,905

Shih shenimet shpjeguese që janë pjesë perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2019
(në Lek)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali i Regjistruar	Fitimi i periudhës	Totali
Gjendja më 01 Janar 2018	-	-	-
Rritja e kapitalit	100	-	100
Humbja i periudhës	-	-2,361,820	-2,361,820
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	100	-2,361,820	-2,361,720
Gjendja më 01 Janar 2019	100	-2,361,820	-2,361,720
Humbja i periudhës	-	-34,820	-34,820
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	100	-2,396,640	-2,396,540

Shënimet e Pasqyrave Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Solvent Rating (“Shoqëria”) është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që është themeluar dhe krijuar në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB) më datën 4 Shtator 2018. Selia e Shoqërisë është në Rruga Myslym Shyri, Hyrja 1, ap.40, ZK 8250, NP 5/315+1-40, vol.17, faqe 132 Tiranë, Shqipëri. Shoqëria është regjistruar në autoritetet fiskale me Numer Identifikimi të Personit të Tatuështem (NIPT) L82104038Q.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është aktivitetet e konsulencës që lidhen me biznesin dhe shërbimet e tjera të menaxhimit. Portalet e internetit.

Administrator të Shoqërisë është Z. Predrag Janjic. Më 31 Dhjetor 2019 shoqëria kishte 9 (nëntë) punonjës.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019 janë përgatitur nga shoqëria TPA Albania shpk dhe janë miratuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 20 Maj 2020.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabel

2.1 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit që janë të përfshira në ligjin e ri të kontabilitetit Ligji Nr 25/2018 datë 10 Maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike dhe parimin e biznesit në vijimësi.

Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë shprehur në Lekë shqiptar, që është monedha raportuese e shoqërisë.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Permbledhje e politikave financiare kontabel (vazhdim)

2.2 Ligji dhe Standarde të reja, interpretime dhe amendime të hyrë në fuqi e të adoptuar (vazhdim)

Politikat e kontabilitetit të miratuara janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar, përveç për sa vijon (NAS) e adoptuar nga Kompania që nga 1 janari 2019:

- **Ligji i Ri per Kontabilitetin në Shqipëri**

Në vijim të punës që po bën qeveria shqiptare në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar më datë 10 maj 2018 ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” (më poshtë “Ligji i ri për kontabilitetin” ose “Ligji i ri”), i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004. Ligji i ri për kontabilitetin është përafshuar pjesërisht me Direktivën 2013/34 të Bashkimit Evropian dhe qëllimi është përafshimi i plotë i tij në vitin 2028. Ligji i ri hyri në fuqi më datë 1 janar 2019. Aplikimi i Ligjit të ri nuk ka ndikim në pozicionin financiar dhe performancën e Shoqërisë dhe në menyrën e përqitjes së pasqyrave financiare.

- **Përmirësime të SKK 2 Prezantimi i Pasqyrave Financiare**

Ndryshimet në SKK 2 Paraqitja e Pasqyrave Financiare sqarojnë sesa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:

- informacioni i nevojshëm për të identifikuar njësinë ekonomike;
- informacion shtesë në lidhje me aktivet e qëndrueshme;
- shumat e kompensuara duhet të jepen për vlerën bruto të tyre tek shënime shpjeguese;
- shënime shpjeguese më të detajuara për të ardhurat.

Këto përmirësime u bënë efektive nga 1 Janar 2019. Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk ka efekt material në Pasqyrat Financiare të Shoqërisë.

- **Përmirësime të SKK 9 Kombinimet e Biznesit**

Ndryshimet në SKK 9 Kombinimet e Biznesit shtojnë disa kërkesa në përputhje me Direktivat Bashkimit Evropian. Ndryshimet qartësojnë:

- prezantimin e pjesëmarrjeve në pasqyrat financiare të konsoliduara
- rast kur nuk përgatiten pasqyra të konsoliduara
- lejimi i raportimit në data të ndryshme
- në shënime të pasqyrave financiare të shpjegohen metodat e përdorura për llogaritjen e vlerës së emrit të mirë në kombinimin e biznesit si dhe çdo ndryshim i rëndësishëm i vlerës së tij në raport me vitin paraardhës financiar;
- në pasqyrat financiare të konsoliduara të mëmës të jepet informacion:
 - (a) në lidhje me të dhëna për njësitë ekonomike të përfshira në konsolidim si emri, selia dhe kapitali i investuar tek to nga mëma
 - (b) emrat dhe selinë e regjistruar të njërive ekonomike ku, njësitë e përfshira në konsolidim tek mëma, kanë interesa pjesëmarrëse
 - (c) emrat dhe selinë e regjistruar të njërive ekonomike të konsoliduara në mënyrë proporcionale
 - (d) në lidhje me secilën prej njërive ekonomike ku mëma mban një interes në pjesëmarrje;
- njësitë ekonomike mëmë disa shënime shpjeguese të caktuara për rastet kur kjo mëmë është e përjashtuar nga detyrimi për të hartuar pasqyra financiare të konsoliduara.

Këto përmirësime u bënë efektive nga 1 Janar 2019. Aplikimi i këtyre ndryshimeve nuk ka efekt material në Pasqyrat Financiare të Shoqërisë.

2.3 Ligje, standarde, interpretime dhe amendamente të reja, të nxjerra, por ende jo efektive dhe të adoptuara.

Gjatë vitit 2019, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit ka miratuar disa përmirësime në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (NAS), të cilat nuk janë efektive në datën e krijimit të pasqyrave financiare të Kompanisë. Këto përmirësime kanë të bëjnë me NAS 3 Instrumentet Financiare, NAS 5 Aktivet materiale dhe jo-materiale afatgjata; NAS 11 Tatim fitimi; NAS 13 Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare. Këto përmirësime do të hyjnë në fuqi në 1 Janar 2020. Zbatimi i këtyre ndryshimeve nuk do të ketë ndonjë efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

2.4 Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale

Aktivët afatgjata materiale dhe jomateriale janë pasqyruar në librat e shoqërisë me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar.

Normat vjetore të zhvlerësimit të aplikuara janë si më poshtë:

	Normat zhvlerësimit % ^e	Bazë e llogaritjes
Aktivët afatgjata materiale	2019	
Mobilje dhe orëndi	20	Vlera kontabël neto
Paisje elektronike	25	Vlera kontabël neto
Aktivët afatgjata jo materiale		
Softwares	25	Vlera kontabël neto
Te tjera aktive jo-materiale	15	Vlera bruto

Vlera kontabël e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale rishikohet për rënie në vlerë kur ndryshimet e rrethanave tregojnë që vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. N.q.s rrethana të tilla ekzistojnë dhe kur vlera kontabël tejkalon vlerën neto të realizueshme, aktivët ose njësitë gjeneruese të parasë do të pakësohen në vlerën e tyre të realizueshme dhe humbjet nga rënia e vlerës njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.5 Aktivët dhe detyrimet financiare

Aktivët dhe detyrimet financiare konsistojnë tërësisht në llogari të arkëtueshme dhe llogari të pagueshme dhe janë pasqyruar në pasqyrën e pozicionit financiar, bazuar në shumat e faturuara.

Provizionet për borxhet e këqija njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Provizionit për borxhet e këqija është vlera e llogaritur nga drejtimi për të absorbuar humbje të mundshme në të ardhmen për llogari të arkëtueshme ekzistuese që mund të bëhen të pambledhshme si pasojë e kushteve ekonomike ekzistuese, rreziqeve të qënësishme dhe të cilësisë së klientëve dhe faktorëve të tjerë relevant, që sigurojnë njohjen aktuale. Vlera e humbjeve specifikisht e identifikuar (psh klientë të klasifikuar si të dyshimtë dhe të humbur) njihen si shpenzime dhe zbriten nga totali i llogarisë së arkëtueshme për atë klient si provizion për borxhet e këqija.

2.6 Mjete monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare përfshijnë para të mbajtura në bankat vendase dhe para në arkë në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

2.7 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në LEK dhe regjistrohen duke përdorur kursin zyrtar në datën e transaksionit. Mjetet monetare dhe zërat e tjerë jomonetare në pasqyrat e pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj janë përkthyer në LEK me kursin zyrtar të këmbimit në datën e pasqyrave. Diferencat e këmbimit që rezultojnë kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë.

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2019

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Permbledhje e politikave financiare kontabel (vazhdim)

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhat kryesore për përkthimin e zërave të pasqyrave të shprehur në monedhë të huaj paraqiten si vijon (në LEK):

	<u>31 Dhjetor 2019</u>	<u>31 Dhjetor 2018</u>
1 EUR	121.77	123.42
1 USD	108.64	107.82

2.7 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhëshme ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ato ndodhin.

2.8 Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me legjislacionin shqipëtar për tatimin mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave me perjashtim të zërave që njihen direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Tatim mbi fitimin është tatim fitimi i pritsëm mbi të ardhurat e tatueshme për vitin, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit dhe çdo korigjim të tatimit të pagueshëm për vitet e kaluara.

Shoqëria merret me zhvillimin e software-ve (planifikim, implementim, testim dhe support i software-ve) për tregun gjerman. Bazuar në ligjin nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar", Neni 28, pika 2, "Për personat juridikë, të cilët ushtrojnë aktivitetet për prodhimin/zhvillimin e software-ve, tatimi mbi fitimin është 5%", Shoqëria ka ndjekur procedurat për aplikimin e kësaj norme tatim fitimi 5% (norma e tatim fitimit të aplikuar në 2018: 5%).

2.9 Përfitimet e pas daljes në pension dhe planet e pensionit

Shoqëria paguan kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit, e gjithashtu bën pagesa për punonjësit e saj, sipas një plani vullnetar pensioni. Qeveria shqipëtare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave kur ndodhin.

2.10 Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerë të drejtë, minus koston e transaksionit të ndodhur. Huamarrjet njihen më vonë me koston të amortizuar. Çdo diferencë ndërmjet parave të marra (minus koston e transaksioneve) dhe vlerës përfundimtare do të njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2.11 Kapitali i aksionerëve

Kapitali i aksionerëve përbëhet nga mjetet monetare kontribuar nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali i aksionerëve kontabilizohet në shumën përkthyer në monedhën vendase të valutës së huaj të kontribuar, duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

2.12 Provizionet

Një provizion njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e detyrimit. Provizionet rishikohen në çdo datë të bilancit të pozicionit financiar dhe rregullohen duke reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parasë është material, shumën e

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2019

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Permbledhje e politikave financiare kontabel (vazhdim)

provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve që pritet të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin. Provizionet nuk njihen për humbjet e ardhshme operative.

2.13 Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten vetëm në shënime shpjeguese, përjashtojt rastet kur mundësia e një daljeje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare, por paraqiten në shënime kur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundur. Vlera e një humbjeje të kushtëzuar njihet si provizion n.q.s është e mundshme që ngjarje të ardhshme do ta konfirmojnë atë, një detyrim i lindur në datën e bilancit kontabel dhe një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së humbjes mund të bëhet.

2.14 Transaksione me palët e lidhura

Palët e lidhura janë ato ku një palë kontrollohet nga tjetra, ose ka influencë të rëndësishme në marrjen e vendimeve financiare ose të biznesit të palës tjetër.

2.15 Ngjarje pas periudhës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që sigurojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrës së pozicionit financiar (ngjarje rregulluese) do të reflektohen në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese do të paraqiten në shënime të pasqyrave financiare kur janë materiale.

3. Vlerësimet e rëndësishme kontabel dhe supozimet

Në aplikimin e politikave kontabel të shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin nr 2, nga drejtimi kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime për vlerën kontabel të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuar në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet tek vlerësimet kontabel do të njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar nëqë rishikimi afekton vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudha të ardhshme nëqë rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe të ardhme.

Pasiguria në gjykime

Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Humbjet nga zhvlerësimi do të njihen në vlerën në të cilën vlera kontabel e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të parase tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson cmimet e pritshme dhe flukset e parase nga cdo njësi gjeneruese të parase dhe përcakton një normë interesi të pershtatshme kur kalkulohet vlera aktuale e këtyre flukseve parash.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi i Shoqërisë në mënyrë të rregullt analizon jetën e dobishme të aktiveve të amortizueshme në datën e pasqyrave financiare. Drejtimi vlerëson që jeta e dobishme të përcaktuar për aktivet paraqet dobishmerinë e pritshme të aktiveve. Vlera kontabel e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin 7. Megjithatë, rezultatet faktike mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve teknologjike.

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2019
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

4. Mjetet monetare dhe ekuivalente

Mjetet monetare dhe ekuivalente janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
<u>Llogari rrjedhëse ne banka</u>		
- në monedhe vendase	517,260	360,582
- në monedhë të huaj	1,478,554	1,272,323
	1,995,815	1,632,905
Totali i mjeteve monetare dhe ekuivalente	1,995,815	1,632,905

5. Të tjera të drejta të arkëtueshme

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Tvsh Kreditore	-	25,670
Te tjera	100	100
Shpenzime të parapaguara	71,307	13,073
Totali	71,407	38,843

6. Aktivet afatgjata materiale

	Pajisje zyre	Total
Kosto		
Më 1 Janar 2019	40,065	40,065
Shtesa	25,093	25,093
Më 31 Dhjetor 2019	65,158	65,158
Amortizimi		
Më 1 Januar 2019		
Amortizimi i vitit	-1,585	-1,585
Më 31 Dhjetor 2019	-10,780	-10,780
	-12,365	-12,365
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2019		
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2019	38,480	38,480

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2019
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

	Pajisje zyre	Total
Kosto		
Më 1 Janar 2018	-	-
Shtesa	40,065	40,065
Më 31 Dhjetor 2018	<u>40,065</u>	<u>40,065</u>
Amortizimi		
Më 1 Januar 2018	-	-
Amortizimi i vitit	-1,585	-1,585
Më 31 Dhjetor 2018	<u>-1,585</u>	<u>-1,585</u>
Vlera Neto Kontabël më 01 Janar 2018	-	-
Vlera Neto Kontabël më 31 Dhjetor 2018	<u>38,480</u>	<u>38,480</u>

7. Furnitorë

Furnitorët përfshijnë detyrimet kundrejt furnitorëve të huaj dhe vendas. Detyrimi për furnitorët vendas është mbyllur. Furnitorët e huaj përfshijnë detyrimet për palët e lidhura. Balancat e furnitorëve janë analizuar si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Furnitore vendas	150,118	478,113
Totali	<u>150,118</u>	<u>478,113</u>

Analiza e furnitorëve të huaj është si më poshtë:

8. Te tjera te pagueshme

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime ndaj punonjesve	25,629	23,318
Detyrime ndaj S. Stamenkovic	13,250	13,250
Total furniturë të huaj	<u>38,879</u>	<u>36,568</u>

Furnitorët nuk mbartin interes dhe zakonisht likujdohen brenda 30 ditëve. Për termat dhe kushtet me palët e lidhura, referohuni Shënimit 19.

9. Paga të pagueshme

Pagat janë likujduar brenda muajit Dhjetor 2019, ndërsa detyrimi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore i përket muajit dhjetor 2019.

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Paga të pagueshme	-	300,515
Sigurime shoqërore e shëndetësore	164,579	95,343
Totali	<u>164,579</u>	<u>395,858</u>

Sigurimet shoqërore e shëndetësore shlyhen jo më vonë se 20 ditë pas mbylljes së muajit pasardhës.

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2019
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

10. Detyrime ndaj shtetit

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)	46,445	25,820
Tatim në burim	8,605	15,325
Tvsh Dhjetor	<u>233,572</u>	<u>-</u>
Totali	<u>288,622</u>	<u>41,145</u>

Detyrimet ndaj autoriteteve tatimore zakonisht shlyhen nga 10 deri në 20 ditë nga mbyllja e muajit.

11. Huamarrje afatgjatë

Gjate vitit 2018 dhe 2019 shoqëria ka marr hua nga shoqëria Solvent d.o.o, si me poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Hua		
Nga Solvent Rating doo	3,874,357	3,120,266
	3,874,357	3,120,266
Minus: pjesen afat-shkurter te borxhit afat-gjate	<u>-186,491</u>	<u>-34,766</u>
Totali huase afatgjate	<u>3,687,866</u>	<u>3,085,500</u>
Hua afat-shkurter		
Plus: pjesen afat-shkurter te borxhit afat-gjate	<u>186,491</u>	<u>34,766</u>
Totali huase afatshkurter	<u>186,491</u>	<u>34,766</u>

12. Kapitali dhe rezervat

Kapitali

Më 31 Dhjetor 2019, sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) totali i kapitalit të regjistruar është 100 Lekë.

Më poshtë është struktura e kapitalit më 31 Dhjetor 2019:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018	%
Solvent d.o.o	<u>100</u>	<u>100</u>	<u>100%</u>
Totali	<u>100</u>	<u>100</u>	<u>100%</u>

13. Shitje e shërbimeve

Të ardhurat nga shitja e të mirave dhe shërbimeve janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Sherbime programesh	<u>9,242,860</u>	<u>206,747</u>
Totali	<u>9,242,860</u>	<u>206,747</u>

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2019
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

14. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Paga	5,558,959	1,218,885
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	<u>985,490</u>	<u>183,131</u>
Totali	<u>6,544,449</u>	<u>1,402,016</u>

Numri mesatar i punonjësve për vitin 2019 ishte 9 (nëntë).

15. Shpenzime administrative dhe të tjera

Shpenzimet administrative dhe të tjera operative përbëhen nga:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Qira	651,997	553,616
Kancelari	490,815	46,445
Shpenzime postare, telefon dhe internet	376,405	112,463
Sherbim Kontabiliteti+Taksa	369,588	131,067
Shpenzime për pritje dhe perfaqesime	265,247	74,721
Shpenzime mirembajtje zyra	78,513	12,285
Taksa dhe tarifa vendore	67,000	22,333
Bl.energji,avull,uje	62,009	11,682
Karburant	37,501	40,800
Sherbim Imobiliar	24,800	44,324
Publicitet reklama	23,000	35,415
Noteri Perkthime	7,700	1,700
Gjoba	727	-
Zbritje akorduar klienteve	<u>-</u>	<u>-8,681</u>
Totali	<u>2,455,301</u>	<u>1,078,172</u>

16. Të ardhurat (shpenzimet) financiare, neto

Të ardhurat/(shpenzimet) financiare përfshijnë fitimet dhe humbjet e realizuara apo të përealizuara nga kurset e këmbimit, të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat dhe të tjera të ardhura financiare si vijon:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Fitim nga kurset e këmbimit	143,932	63,801
(Humbje) nga kurset e këmbimit	<u>-117,975</u>	<u>-40,397</u>
Fitim/(Humbje) neto nga kurset e këmbimit	<u>25,958</u>	<u>23,404</u>
Shpenzime interesi për huanë	<u>-188,797</u>	<u>-35,083</u>
Shpenzime neto interesi	<u>-188,797</u>	<u>35,083</u>
Të tjera shpenzime financiare (komisione bankare)	<u>-104,310</u>	<u>-75,116</u>
Të tjera të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	<u>-104,310</u>	<u>-75,116</u>
Totali të ardhurave/(shpenzimeve) financiare neto	<u>-267,149</u>	<u>-86,795</u>

Pasqyrat Financiare
Shënimet e pasqyrave financiare (vazhdim)

Për vitin që mbyllet në 31 Dhjetor 2019
Të gjitha shumat janë shprehur në Lek

17. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatim fitimit për vitin 2019 i llogaritur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1 Fitimi para tatimit	-34,820	-2,361,820
2 Shpenzime të pazbritshme	356,796	106,653
3 Penalitete, gjoba	727	-
4 Fitimi / (humbje) e tatueshme (1+2+3)	322,703	-2,255,167
5 Humbje të mbartura (-)	-2,255,167	-
6 Fitim (humbje) e tatueshme	-1,932,464	-2,255,167
7 Norma e tatimit mbi fitimin	5%	5%
8 Shpenzim tatim fitimi	-	-
9 Tatim fitimi i parapaguar	-	-
10 Tatim fitimi i arketueshem (i pagueshëm)	-	-

18. Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

Angazhime

Shoqëria nuk ka angazhime materiale të nënkontraktuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar të cilat të mos jenë reflektuar në pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe të dhënat kontabël për vitet financiare që përfundojnë më 31 Dhjetor 2019 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore të Shoqërisë mund të mos konsiderohen të finalizuara. Detyrime tatimore shtesë që mund të lindin në rast të auditimit të autoriteteve tatimore nuk mund të percaktohen me saktësi.

Çështje ligjore

Më 31 Dhjetor 2019 nuk ka çështje gjyqësore të ngritura kundër shoqërisë ose nga shoqëria.

19. Transaksionet me palët e lidhura

Shoqëria ka kryer transaksione sipas çmimeve të tregut me palët e lidhura gjatë aktiviteteve të saj normale të biznesit. Tabela e mëposhtme përmbledh qëllimin dhe balancat nga transaksionet e palëve të lidhura:

20. Ngjarje pas datës së raportimit

Mbas datës 31 Dhjetor 2019 – datë e raportimit dhe e aprovimit të pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje materialisht të rëndësishme që të mund të ndikojnë në këto pasqyra financiare.

Në fund të vitit 2019 dolën për herë të parë lajmet nga Kina në lidhje me COVID-19 (Coronavirus). Situata në fund të vitit ishte se një numër i kufizuar i rasteve të një virusi të panjohur ishin raportuar në Organizatën Botërore të Shëndetit. Në muajt e parë të vitit 2020 virusi ishte përhapur globalisht dhe ndikimi i tij negativ ka fituar një impuls. Manaxhimi e konsideron që informacioni të jetë një ngjarje jo rregulluese pas datës së raportimit. Ndërsa kjo është ende një situatë në zhvillim në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare, deri më tani nuk ka pasur ndonjë ndikim të dukshëm në operimet e Kompanisë, megjithatë efektet e ardhshme nuk mund të parashikohen. Manaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat e mundshëm për të zbutur çdo efekt.

Deklarata e hartuesit të pasqyrave financiare

Për Drejtimin dhe Ortakët e
Solvent Rating Shpk (referuar më poshte si “shoqëria”).

Ne kemi hartuar pasqyrat financiare të shoqërisë në bazë të dokumenteve që ju na keni ofruar. Këto pasqyra financiare përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë më 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e flukseve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Para hartimit të pasqyrave financiare të shoqërisë, TPA Albania shpk kreu shërbimet e kontabilitetit të cilat përfshinin regjistrimin e veprimeve kontabël dhe përgatitjen e bilancit verifikues.


Ne kemi aplikuar ekspertizën tonë në kontabilitetit dhe raportim financiar për t’ju ndihmuar në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Shqipërisë. Ne kemi qenë në përputhje me kërkesat etike relevante, duke përfshirë edhe parimet e integritetit, objektivitetit, kompetencën profesionale dhe kujdesin e duhur.

Këto pasqyra financiare, saktësia dhe plotësia e dokumenteve dhe informacionit të përdorura për të përpiluar ato janë përgjegjësia juaj. Përgjegjësia jonë është të hartojmë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuara), Ligjin 25/2018 date 10 Maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm nr. 9228, datë 29.4.2004.

Meqenëse shërbimi i hartimit të pasqyrave financiare nuk është një shërbim sigurie, ne nuk jemi të detyruar të verifikojmë plotësinë e dokumenteve që ju na keni ofruar për hartimin e këtyre pasqyrave financiare. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion auditimi ose një konkluzion nëse këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri.

Pasqyrat financiare të kompanisë janë përgatitur në gjuhën Angleze dhe përkthyer në gjuhën Shqipe. Versioni në gjuhën Angleze do të jetë versioni relevant ligjor dhe do të ketë përparësi ligjore në rast të ndonjë mospërputhje midis tekstit në Aglisht dhe përkthimit në ndonjë gjuhë tjetër.

Tirana,
20 Maj 2020


Ilir Binaj CPA, CGMA
EKR Lic. Nr.205 datë 04.10.2010

